



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivered	01.06.2023	viti god year	
Organ /Njesia Org./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SMB/SHHC	4568/2023		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.659/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Kaltrina Avdullahi Prenaj -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.659/2023 të datës 20.04.2023 të parashtruar nga ankuesja

kundër organit të punësimit, Zyra e Presidencës së Republikës së Kosovës, në çështjen juridike "Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 31.05.2023, morri këtë:

V E N D I M

HEDHET POSHTË si e palejuar ankesa me numër A.nr.659/2023 e datës 20.04.2023 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Zyrën e Presidencës së Republikës së Kosovës, sipas Akt Emërimit të datës 07.05.2015 në pozitën e punës "Udhëheqëse e Divizionit të Personelit" në Divizionin e Personelit, me datën 20.04.2023 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 3708/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër të protokollit Nr.02/116-255-02/23 të datës 23.03.2023 të Komisionit Disiplinor në Zyrën e Presidencës, me pretendimin ankimor se Komisioni Disiplinor, i formuar nga U.d i Zyres së Presidencës nuk ka marrë për bazë, Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, Ligjin 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren (QRK) 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, gjegjësisht për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale dhe vlerësimit jo të drejtë të provave materiale .

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 17.05.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Zyra e Presidentes së Republikës së Kosovës. Ndërsa Këshilli me datën 19.05.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë, së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka Administruar këto Prova: Ankesë me numër protokollit 3708/2023 e datës 20.04.2023; Ankesë me numër të protokollit 02/07-256-01/23 e datës 24.02.2023; Vendim me numër Nr.06/2023 i datës 15.01.2021 për themelimin e Komisionit Disiplinor i nënshkruar nga u.d. Sekretar i Zyrës së Presidentes; Vendim me numër Nr.24/2023 i datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit me numër Nr.06/2021 i datës 15.01.2023 i nënshkruar nga u.d Sekretar i Zyrës së Presidentes; Vendim me numër Nr.01.2023 i datës 23.03.2023; E-mail i datës 20.04.2023; Akt Emërimi i datës 07.05.2015; Listë me përshkrimin e detyrave të punës; E-mail i datës 27.03.2023; Procesverbalet e takimeve të Komisionit Disiplinor të datave 07.03.2023, 08.03.2023 dhe 15.03.2023.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke i shqyrtuar të gjitha provat e lëndës ka konstatuar që ankesa e ankueses **është e palejuar, sepse:**

Bazuar në shkresat e lëndës rezulton se ankuesja Mahije Haradinaj, e punësuar në Zyrën e Presidentes së Republikës së Kosovës, sipas Akt Emërimit të datës 07.05.2015 ushtron pozitën e punës "Udhëheqëse e Divizionit të Personelit" në Divizionin e Personelit. Ankuesja me datë 24.02.2023 përmes shkresës zyrtare ka kërkuar nga Sekretari i përgjithshëm që të ndërmarrë masa ndaj nëpunëses civile N.B, U.d Udhëheqëse e Divizionit për Shërbime Gjuhësore në Presidencë lidhur me kërcënimet që ka bere ndaj saj. Sekretari i përgjithshëm i Zyrës se Presidencës me date 24.02.2023 ka bere kërkesë për inicimin e procedurës disiplinore tek Komisioni disiplinor.

Komisioni Disiplinor në Zyrën e Presidencës, pas mbajtjes së seancave disiplinore më datë 07.03.2023, 08.03.2023 dhe 15.03.2023, ka nxjerrë Vendim me numër të protokollit Nr.02/116-255-02/23 me të cilin ka vendosur se rasti me numër Nr.02/116-255-01/2023 i datës 24.02.2023, lidhur me inicimin e procedurës disiplinore për konfliktin verbal të ndodhur në Zyrën e Presidencës ne mes të Udhëheqës së Divizionit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore dhe N.B., U.d Udhëheqëse e Divizionit për Shërbime Gjuhësore në Presidencë, nuk përmban elemente që mund të klasifikohen si shkelje të rënda disiplinore të përcaktuara me nenin 46 paragrafi 3.6 dhe 3.8 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe si i tillë nuk hyn në kuadër të kompetencave të Komisionit Disiplinor, ndërsa në pikë dy (II) të dispozitivit të vendimit me numër të protokollit Nr.02/116-255-02/23 të datës 23.03.2023, Komisioni Disiplinor i rekomandon Mbikëqyrësve të Drejtpërdrejtë që të ndërmarrin masat për shkeljet e lehta eventuale në pajtim me nenin 46, paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, si dhe Rregulloren (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë

Ankuesja e pakënaqur me Vendimin me numër të protokollit Nr.02/116-255-02/23 të datës 23.03.2023 të Komisionit Disiplinor të Zyrës së Presidencës, me datën 20.04.2023



parashtron ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me numër protokollit 3708/2023 me pretendime ankimore se Komisioni Disiplinor nuk ka marrë për bazë Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrarët Publik, Ligjin 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren (QRK) 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrarëve Publik, gjegjësisht për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale dhe vlerësimit jo të drejtë të provave materiale dhe ka kërkuar që të anulohet Vendimi i datës 23.03.2023 i Komisioni Disiplinor

Lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankueses, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka analizuar dispozitat ligjore në fuqi, duke konstatuar se me nenin 24 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrarët Publikë, përcaktohet se: *“Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankese drejtpërdrejt në KPMSHCK për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji”*. *“E drejta e ankimit në KPMSHCK i njihet edhe çdo kandidati në një procedurë pranimit në Shërbimin Civil. Pas shterimit të drejtës së ankimit në KPMSHCK, mund të iniciohet konflikt administrativ në Gjykatën kompetente për çështjet administrative”*, ndërsa se kush konsiderohet palë në procedurën administrative, Kolegji i’u referua nenit 14 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“1. Palë në procedurën administrative mund të jetë çdo person fizik, person juridik apo grup personash me një interes të përbashkët: 1.1. me kërkesë të të cilit organi publik ka filluar procedura administrative; 1.2. ndaj të cilit ka filluar procedura administrative apo të cilit rezultati i procedurës administrative mund t’i cenojë të drejtat apo interesat juridike. 2. Palë në procedurën administrative janë, gjithashtu, dhe mbrojtësit e interesave publike të autorizuar me ligj të veçantë, si dhe mbrojtësit e interesave kolektive apo të interesave të gjera të publikut, nëse këto interesa mund të cenohen nga rezultati i procedurës administrative”*. Ndërsa me nenin 124 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përcaktohet legjitimimi, shkaqet dhe mjetet juridike administrative, ndërsa paragrafi 1 i këtij neni përcakton që: *“Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim. Anëtar i një organi kolegji, ka gjithashtu të drejtën të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi procedural të organit kolegji, nëse pretendon se një nga dispozitat e neneve 37-43 të këtij Ligji janë shkelur nga një veprim apo mosveprim i tillë, kështu që Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vlerëson se me Vendimin me numër të protokollit Nr.02/116-255-02/23 të datës 23.03.2023, të kundërshtuar me ankese, nuk i është cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik i ankueses, rrjedhimisht ankuesja nuk ka legjitimitetin e palës për të parashtruar ankese kundër Vendimit me numër të protokollit Nr.02/116-255-02/23 të datës 23.03.2023 të Komisionit Disiplinor të Zyrës së Presidencës, kështu që bazuar në këtë konstatim si dhe në mbështetje të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedh se ankesa me numër A.nr.659/2023 dhe numër të protokollit 3708/2023 e datës 20.04.2023 e parashtruar nga ankuesja Mahije Haradinaj është e pa pranueshme.*

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.659/2023.

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

[Signature]
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

[Signature]
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Njesisë së Burimeve Njerëzore në Zyrën e Presidencës së Republikës së Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.